



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në pajtim me nenet 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a) dhe (c), 21.2, 78, 79 dhe 80 pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, nr. 28, më datë 4 qershor 2008),

Duke pasur parasysh,

Detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës karshi Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (në tekstin e mëtejme "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj e përkohshme në fuqi për Kosovën më 10 tetor 2006,

Me qëllim të zbatimit të Rregullores (CE) 255/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 mars, në kuadër të rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për procedurat për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. xx/2017 PËR RREGULLAT E PËRBASHKËTA PËR
MENAXHIMIN E FLUKSIT TË TRAFIKUT AJROR**

Neni 1

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për menaxhimin e fluksit të trafikut ajror (në tekstin e mëtejme: MFTA) në mënyrë që të optimizohet kapaciteti i disponueshëm i Rrjetit Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror (në tekstin e mëtejme: RrEMTA) dhe të përmirësohen proceset e MFTA-së.
2. Rregullorja zbatohet brenda hapësirës ajrore të referuar në nenin 1(3) të Rregullores (EC) nr. 551/2004, të transpozuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës me anë të Rregullores e AAC-së nr. 10/2009, për:

- (a) të gjitha fluturimet që synohet të operohen ose që operohen si trafik ajror i përgjithshëm dhe në përputhje me rregullat e fluturimit instrumental (në tekstin e mëtejshëm: RrFI) në tërësi ose pjesërisht;
- (b) të gjitha fazat e fluturimeve të referuara në pikën (a) dhe të menaxhimit të trafikut ajror.

3. Kjo rregullore zbatohet për palët në vijim, ose agjentët që veprojnë në emër të tyre, të përfshira në proceset e MFTA-së:

- (a) operatorët e avionëve,
- (b) njësitë e shërbimit të trafikut ajror (në tekstin e mëtejshëm: ShTA), duke përfshirë zyrat e raportimit të ShTA-së dhe shërbimet e kontrollit të aerodromit;
- (c) shërbimet e informacionit aeronautik;
- (d) subjektet e përfshira në menaxhimin e hapësirës ajrore;
- (e) organet menaxhuese të aeroportit;
- (f) njësia qendrore e MFTA-së;
- (g) njësitë lokale të MFTA-së;
- (h) koordinatorët e slotëve të aeroporteve të koordinuara.

Neni 2

Shprehjet dhe përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e parashikuara në nenin 2 të Rregullores (EC) nr. 549/2004, të transpozuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës me anë të Rregullores së AAC-së nr. 08/2009 dhe nenin 2 të Rregullores së Këshillit nr. 95/93, të transpozuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës me anë të Rregullores nr. 2008/6.

Gjithashtu, në këtë rregullore zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

'masa e menaxhimit të fluksit të trafikut ajror (MFTA)' nënkupton veprimet e ndërmarra për të kryer menaxhimin e fluksit të trafikut ajror dhe menaxhimin e kapaciteteve;

'operator' nënkupton një person, organizatë ose ndërmarrje e cila angazhohet ose ftohet për t'u angazhuar në drejtimin e operimit të një avioni;

'rregullat e fluturimit instrumental (RrFI)' nënkupton rregullat e fluturimit instrumental siç përcaktohet në Shtojcën 2 të Konventës së Çikagos të vitit 1944 mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejshëm: Konventa e Çikagos);

'zyra e raportimit të shërbimeve të trafikut ajror (ShTA)' nënkupton njësinë e ShTA-së të themeluar me qëllim të marrjes së raporteve në lidhje me ShTA-në dhe planeve të fluturimit të dorëzuara para dhënies së parë të autorizimit të kontrollit të trafikut ajror;

'njësia lokale e menaxhimit të fluksit të trafikut ajror (MFTA)' nënkupton njësinë e menaxhimit të fluksit e cila operon në emër të një ose më shumë subjekteve të menaxhimit të fluksit si ndërlidhëse mes njësisë qendrore të MFTA-së dhe një njësie të ShTA-së ose një grup të njësive të tilla;

'ngjarje kritike' nënkupton një situatë të pazakontë apo krizë e cila përfshin një humbje të madhe të kapacitetit të RrEMTA-së, ose një çekuilibër të madh midis kapacitetit dhe kërkesës së RrEMTA-s, ose një mosfunksionim të madh në fluksin e informacionit në një ose disa pjesë të RrEMTA-së;

'sloti i nisjes i menaxhimit të fluksit të trafikut ajror (MFTA)' nënkupton kohën e llogaritur të ngritjes, e dhënë nga njësia qendrore e MFTA-së me një tolerancë kohore të menaxhuar nga njësia lokale e ShTA-së;

'orientimi i rrugëve dhe trafikut' nënkupton politikat dhe procedurat për përdorimin e rrugëve nga avioni;

'plani i shumëfishtë i fluturimit' nënkupton më shumë se një plan fluturimi për të njëjtin fluturim midis dy aeroporteve;

'konfigurimi i sektorit të njësisë së shërbimit të trafikut ajror (ShTA)' nënkupton përshkrimin katërdimensional të sektorit, ose grupit të sektorëve, të hapësirës ajrore të njësisë së ShTA-së, të cilët mund të operohen mbi një bazë të përhershme ose të përkohshme;

'koha e taksisë në aerodrom' nënkupton vlerën e paracaktuar kohore nga vendi i qëndrimit deri në nisje, e shprehur në minuta dhe e vlefshme gjatë operacioneve normale të aeroportit;

'pozicioni i përditësuar i fluturimit' nënkupton pozicionin e avionit, i përditësuar nga të dhënat e vëzhgimit, të dhënat e planit të fluturimit ose raportet e pozicionit;

'autorizimi i kontrollit të trafikut ajror' nënkupton autorizimin që një avion të veprojë sipas kushteve të përcaktuara nga një njësi e kontrollit të trafikut ajror;

'pezullimi i planit të fluturimit' nënkupton procesin e iniciuar nga një subjekt që kryen MFTA-në për t'u siguruar që bëhet një ndryshim në planin e fluturimit nga operatori para kryerjes të fluturimit;

'shërbim ajror' nënkupton një fluturim ose një seri fluturimesh që transportojnë pasagjerë, mallra ose postë kundrejt kompensimit ose qirasë;

'regjistri operacional' nënkupton regjistrin e sistemit të MFTA-së, i konvertuar në një bazë të dhënash për të lejuar kërkimin e shpejtë të të dhënave të MFTA-së.

Neni 3

Korniza e menaxhimit të fluksit të trafikut ajror

1. Planifikimi, koordinimi dhe zbatimi i masave të MFTA-së nga ana e palëve të referuara në nenin 1(1.3) duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ICAO-s të specifikuar në Shtojcë.

2. MFTA duhet të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) masat e MFTA-së duhet:

(i) të parandalojnë kërkesat e tepruara të trafikut ajror krahasuar me kapacitetin e deklaruar të trafikut ajror (KTA) të sektorëve dhe aeroporteve;

(ii) të përdorin kapacitetin e RrEMTA-së në masën maksimale të mundshme, në mënyrë që të optimizojnë efikasitetin e MFTA-së dhe të minimizojnë efektet negative mbi operatorët;

(iii) të optimizojnë kapacitetin e RrEMTA-së të vënë dispozicion nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të masave për rritje të kapaciteteve, të siguruara nga njësitë e ShTA-së;

(iv) të mbështesin menaxhimin e ngjarjeve kritike;

b) njësitë lokale të MFTA-së dhe njësia qendrore të MFTA-së duhet të konsiderohen si pjesë të funksionit të MFTA-së.

3. Caktimi i slotëve të nisjes të MFTA-së duhet t'u japë prioritet fluturimeve sipas rendit të hyrjes së tyre të planifikuar në vendin ku do të aplikohen masat të MFTA-së, përveç nëse rrethanat e veçanta kërkojnë aplikimin e një rregulli të ndryshëm prioritar për të cilin arrihet dakordim zyrtar dhe është në dobi të RrEMTA-së.

Nënparagrafi i parë mund të aplikohet për fluturime të cilat nuk janë në gjendje të pranojnë opsionin e një rruge tjetër për të shmangur ose zbutur zonat e dendura, duke marrë parasysh vendndodhjen dhe shtrirjen e zonës së dendur.

Neni 4

Detyrimet e përgjithshme të Republikës së Kosovës

1. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që funksioni i MFTA-së është në dispozicion për palët e referuara në nenin 1(3) gjatë 24 orëve.

2. Përcaktimi dhe zbatimi i masave të MFTA-së duhet të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës, me qëllim që të sigurohet efikasiteti në planifikimin, caktimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore në interes të palëve të referuara në nenin 1(3).

3. Procedura konsistente duhet të vendosen për bashkëpunimin midis palëve të përfshira në funksionimin e MFTA-së, njësitë të ShTA-së dhe subjekteve të përfshira

në menaxhimin e hapësirës ajrore, me qëllim që të optimizohet përdorimi i hapësirës ajrore.

4. Duhet të krijohet një dokument i përbashkët referimi që përmban politikat, procedurat dhe përshkrimin për orientimin e rrugëve dhe trafikut. Aty ku është e mundur, publikimi i disponueshmërisë së rrugëve në publikimet kombëtare të informacionit aeronautik duhet të jetë plotësisht në përputhje me këtë dokument të përbashkët referimi.

5. Procedurat e zakonshme për të kërkuar përjashtim nga një slot nisjeje i MFTA-së duhet të hartohen në përputhje me dispozitat e ICAO-s të specifikuar në Shtojcë. Këto procedura duhet të koordinohen me njësinë qendrore të MFTA-së dhe të publikohen në publikimet kombëtare të informacionit aeronautik.

Neni 5

Detyrimet e Republikës së Kosovës në lidhje me njësinë qendrore të MFTA-së

Republika e Kosovës duhet të sigurojë që njësia qendrore e MFTA-së:

(a) optimizon efektet e performances së përgjithshme mbi RrEMTA-në me anë të planifikimit, koordinimit dhe zbatimit të masave të MFTA-së;

(b) këshillohet me operatorët në përcaktimin e masave të MFTA-së;

(c) siguron zbatimin efektiv të masave të MFTA-së, së bashku me njësitë lokale të MFTA-së;

d) në koordinim me njësitë lokale të MFTA-së, identifikon rrugët alternative për të shmangur ose zbutur zonat e dendura, duke marrë parasysh efektet e përgjithshme të performancës në RrEMTA;

(e) ofron një rrugë tjetër alternative për ato fluturimet që do të optimizonin efektin e pikës (d);

(f) u siguron operatorëve dhe njësive të ShTA-së informacion mbi MFTA-në në kohën e duhur, duke përfshirë:

(i) masat e planifikimit të MFTA-së;

(ii) ndikimin e masave të MFTA-së në kohën e ngritjes dhe profilin e fluturimit të fluturimeve individuale;

(g) monitoron zhvillimin e planeve të fluturimeve të humbura dhe planeve të fluturimeve të shumëfishta që janë dorëzuar.

(h) pezullon planin e fluturimit kur, duke marrë parasysh tolerancën kohore, sloti i nisjes i MFTA-së nuk mund të plotësohen dhe koha e qëndrimit e vlerësuar nuk është e njohur;

(i) monitoron numrin e përjashtimeve të lejuara në përputhje me nenin 4(5).

Neni 6

Detyrimet e përgjithshme të njësive të ShTA-së

1. Kur duhet të zbatohet një masë e MFTA-së, njësitë e ShTA-së duhet të koordinohen nëpërmjet njësisë lokale të MFTA-së me njësinë qendrore të MFTA-së, në mënyrë që të sigurohet se zgjedhja e masës është bërë me qëllim të optimizimit të efekteve të përgjithshme të performancës të RrMTA-ja.

2. Kur është e nevojshme, zyrat e raportimit të ShTA-së duhet të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit midis pilotëve ose operatorëve dhe njësisë lokale ose qendrore të MFTA-së.

3. Njësitë e ShTA-së duhet të sigurojnë që masat e MFTA-së të aplikuara për aeroportet janë të koordinuara me organizmin menaxhues të aeroportit në fjalë, në mënyrë që të sigurojnë efikasitetin në planifikimin dhe përdorimin e aeroportit në dobi të palëve referuar në nenin 1 (3).

4. Njësitë e ShTA-së duhet të njoftojnë njësinë qendrore të MFTA-së nëpërmjet njësisë lokale të MFTA-së për të gjitha ngjarjet që mund të ndikojnë në aftësinë e kontrollit të trafikut ajror ose kërkesat e trafikut ajror.

5. Njësitë e ShTA-së duhet të sigurojnë njësinë qendrore të MFTA-së me të dhënat e mëposhtme dhe të përditësuara, në kohën e duhur dhe për të siguruar cilësinë tyre:

a) disponueshmërinë e hapësirës ajrore dhe strukturës së rrugës;

b) konfigurimin dhe aktivizimin e sektorit të njësisë së ShTA-së;

c) kohën e taksisë në aerodrom;

d) sektorin e kontrollit të trafikut ajror dhe kapacitetet e aeroportit;

(e) disponueshmërinë e rrugës duke përfshirë disponueshmërinë nëpërmjet aplikimit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore, në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 2150/2005, të transpozuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës me anë të Rregullores së AAC-së nr. 18/2010,

f) pozicionet e përditësuara të fluturimit;

g) devijimet nga planet e fluturimit;

(h) disponueshmëria e hapësirës ajrore, duke përfshirë disponueshmërinë nëpërmjet aplikimit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore, në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 2150/2005, të transpozuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës me anë të Rregullores së AAC-së nr. 18/2010,

i) koha e nisjes së fluturimit aktual.

Të dhënat duhet të vihen në dispozicion të palëve të referuara në nenin 1 (3) dhe të ofrohen falas për, dhe nga njësi qendrore për MFTA.

6. Njësia e ShTA-së në aeroportin e nisjes duhet të sigurojë që:

- a) kur një fluturim është objekt i një sloti nisjeje të MFTA-së, ky slot është përfshirë si pjesë e pastrimit të kontrollit të trafikut ajror;
- b) fluturimet u bashkohen slotëve të nisjes të MFTA-së;
- c) fluturimet që nuk i bashkohen kohës së nisjes së vlerësuar, duke marrë parasysh kohën e tolerancës, nuk marrin autorizim për nisje;
- d) fluturimet, plani i të cilëve është refuzuar ose anuluar, nuk marrin autorizim për ngritje.

Neni 7

Detyrimet e përgjithshme të operatorëve

1. Çdo fluturim i qëllimshëm duhet të jetë i mbuluar nga një plan fluturimi i vetëm. Plani i paraqitur i fluturimit duhet të pasqyrojë saktë profilin e synuar të fluturimit.
2. Të gjitha masat përkatëse të MFTA-së dhe ndryshimet në to duhet të përfshihen në operacionin e fluturimit të planifikuar dhe t'i komunikohen pilotit.
3. Ku nisen nga një aeroport që nuk është objekt i një sloti nisjeje të MFTA-së, operatorët janë përgjegjës për ta futur në kohën e qëndrimit të vlerësuar duke marrë parasysh një tolerancë kohore të përcaktuara në dispozitat e ICAO-s të specifikuar në Shtojcë.
4. Kur një plan fluturimi është pezulluar në përputhje me nenin 5 (h), operatori i interesuar duhet të rregullojë përditësimin ose anulimin e planit të fluturimit.

Neni 8

Detyrimet e përgjithshme të organeve drejtuese të aeroportit

Organet menaxhuese të aeroportit do të njoftojnë njësinë qendrore të MFTA-së, drejtpërdrejt ose nëpërmjet njësisë lokale të MFTA-së, ose njësive të ShTA-së, ose të dyjave, për të gjitha ngjarjet që mund të ndikojnë në kapacitetet e kontrollit të trafikut ajror ose kërkesat trafikut ajror. Ato duhet ta informojnë njësinë lokale të MFTA-së dhe njësitë e ShTA-së ku njoftimi bëhet drejtpërdrejt.

Neni 9

Konsistenca midis planeve të fluturimit dhe slotëve të aeroportit

1. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që, kur kërkohet nga një koordinator i slotit të aeroportit ose nga një organ drejtues i një aeroporti të koordinuar, njësi qendrore e MFTA-së apo njësitë lokale të MFTA-së u ofrojnë atyre planin e fluturimit të pranuar të një fluturimi që operon në atë aeroport, para se të zhvillohet fluturimi. Koordinatorët e slotit të aeroportit apo organet drejtuese të aeroporteve të

koordinuara duhet të organizojnë qasjen në planet e fluturimeve të pranuar të ofruara nga njësia qendrore e MFTA-së ose njësia lokale e MFTA-së.

2. Para fluturimit, operatorët duhet t'u sigurojnë aeroportëve informacionin e nevojshëm për nisjen dhe mbërritjen, për të mundësuar një korrelacion midis përcaktuesit të fluturimit të përfshirë në planin e fluturimit dhe atij të njoftuar për slotin e aeroportit përkatës.

3. Çdo operator, organ i menaxhimit të aeroportit dhe njësi e ShTA-së ka të drejtën e raportimit tek koordinatori i slotit të aeroportit për realizimin e përsëritur të shërbimeve ajrore në kohë që dallojnë dukshëm nga slotet e caktuara të aeroportëve apo me përdorimin e slotëve në mënyrë shumë të ndryshme nga ajo e treguar në kohën e caktimit, në rastin kur kjo dëmton aeroportin ose operacionet e trafikut ajror.

4. Republika e Kosovës duhet të sigurojë se njësia qendrore e MFTA-së u raporton koordinatorëve të slotëve të aeroportit mbi realizimin e përsëritur të shërbimeve ajrore në kohë që dallojnë nga ato të caktuara në slotet e aeroportit apo me përdorimin e slotëve në një mënyrë shumë të ndryshme nga ajo e treguar në kohën e caktimit, kur kjo sjell dëmtime të MFTA-së.

Neni 10

Detyrimet në lidhje me ngjarjet kritike

1. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që procedurat e MFTA-së për trajtimin e ngjarjeve kritike janë krijuar dhe publikuar nga njësia qendrore e MFTA-së, në mënyrë për të minimizuar pengimin e funksionimit të RrEMTA-së.

2. Në përgatitje për ngjarjet kritike, njësitë e ShTA-së dhe organet menaxhuese të aeroportit duhet të koordinojnë lidhjen dhe përmbajtjen e procedurave të paparashikuara me operatorët e prekur nga ngjarjet kritike, duke përfshirë çdo përshtatje të rregullave prioritare. Procedurat e paparashikuara duhet të përfshijnë:

(a) masat organizative dhe koordinuese,

(b) masat e MFTA-së për të menaxhuar qasjen në zonat e prekura për të parandaluar kërkesat e tepërta të trafikut ajror në krahasim me kapacitetin e deklaruar plotësisht ose pjesërisht të hapësirës ajrore ose aeroportëve në fjalë;

c) rrethanat, kushtet dhe procedurat për zbatimin e rregullave prioritare për fluturime, të cilat respektojnë sigurinë esenciale të Republikës së Kosovës ose interesat e politikës së mbrojtjes;

d) masat e rikuperimit.

Neni 11

Monitorimi i respektimit të masave të MFTA-së

1. Republika e Kosovës duhet të sigurojë se në rastin kur hyrja në slotet e nisjes të MFTA-së në një aeroport nisjeje është 80% ose më pak gjatë një viti, njësia e ShTA-së në atë aeroport duhet të japë informacionin e duhur për mosrespektimin dhe veprimet për të siguruar respektimin e slotëve të nisjes të MFTA-së. Veprime të tilla do të cekën në raportin që Republika e Kosovës do t'ia dorëzojë Komisionit.

2. Njësia e ShTA-së e aeroportit në fjalë duhet të japë informacionin e duhur për çdo dështim për t'iu përmbajtur refuzimeve të planit të fluturimit ose pezullimit në atë aeroport dhe të veprimeve të ndërmarra për të siguruar respektimin. Veprime të tilla do të cekën në raportin që Republika e Kosovës do t'ia dorëzojë Komisionit.

3. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që:

(a) njësia qendrore e MFTA-së njofton Shtetin Anëtar i cili lejon përjashtime në mbi 0,6 % të nisjeve vjetore të atij Shteti Anëtar;

(b) kur një Shtet Anëtar është njoftuar sipas pikës (a), ai duhet të hartojë një raport duke dhënë detaje të përjashtimeve të lejuara, i cili do t'ia dorëzohet Komisionit.

4. Republika e Kosovës duhet të sigurojë se, kur identifikohet mosrespektimi i masave të MFTA-së i cili ka rezultuar nga zbatimi i nenit 5 (g), njësia qendrore e MFTA-së duhet ta njoftojë operatorin që ka bërë respektimin në fjali.

5. Operatorët duhet të paraqesin një raport tek njësia qendrore e MFTA-së për çdo mospërputhje me masat e MFTA-së duke dhënë detaje të rrethanave që kanë rezultuar në humbjen e planit të fluturimit apo të planeve të fluturimeve të shumëfishta dhe veprimeve të ndërmarra për të korrigjuar papajtueshmëri të tilla.

6. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që njësia qendrore e MFTA-së përgatit një raport vjetor, i cili ofron detaje për planet e fluturimeve të humbura apo planet e fluturimeve të shumëfishta që janë paraqitur dhe se raporti i është dorëzuar Komisionit.

7. Republika e Kosovës duhet të kryejë një rishikim vjetor të respektimit të masave të MFTA-së për të siguruar që palët e referuara në nenin 1 (3) kanë përmirësuar nivelin e respektimit të këtyre masave.

Neni 12

Vlerësimi i performancës

1. Me rastin e zbatimit të nenit 11, Republika e Kosovës duhet të sigurohet që njësia qendrore e MFTA-së përgatit raporte vjetore që tregojnë cilësinë e MFTA-së, të cilat duhet të përfshijnë detaje për:

a) shkaqet e masave të MFTA-së;

(b) ndikimin e masave të MFTA-së;

(c) respektimin e masave të MFTA-së;

(d) kontributet nga palët e përmendura në nenin 1 (3) për optimizimin e ndikimit të përgjithshëm të rrjetit.

2. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që njësi qendrore të MFTA-së të krijojë dhe mirëmbajë një arkiv me të dhënat e MFTA-së të renditura në nenin 6 (5), planet e fluturimit, dokumentet operationale dhe të dhënat përkatëse kontekstuale.

Të dhënat e përmendura në nënparagrafin e parë do të ruhen për 2 vjet nga data e paraqitjes së tyre dhe do të vihen në dispozicion të Komisionit, Republikës së Kosovës, njësi të ShTA-së dhe operatorëve.

Të dhënat duhet të vihen në dispozicion të koordinatorëve të aeroportit dhe operatorëve të aeroporteve për të ndihmuar në vlerësimin e tyre të rregullt të kapacitetit të deklaruar.

Neni 13

Kërkesat e sigurisë

Republika e Kosovës duhet të sigurojë se është kryer një vlerësim i sigurisë, duke përfshirë identifikimin e rrezikut, vlerësimin e rrezikut dhe zvogëlimin, para çdo ndryshimi domethënës të sistemeve dhe procedurave të MFTA-së, duke përfshirë një vlerësim të procesit të menaxhimit të sigurisë adresuar ciklit të plotë të jetës të sistemit të menaxhimit të trafikut ajror.

Neni 14

Kërkesat shtesë

1. Republika e Kosovës duhet të sigurojë se personeli i palëve të referuara në nenin 1 (3) të përfshira në aktivitete të MFTA-së:

a) janë vënë në dijeni të dispozitave të kësaj rregulloreje;

b) janë trajnuar në mënyrën e duhur; dhe

c) janë kompetentë për funksionet e tyre të punës.

2. Republika e Kosovës duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar se palët e referuara në nenin 1(3) me përgjegjësitë për funksionet e MFTA-së:

a) zhvillojnë dhe kanë manuale operationesh, të cilat përmbajnë instruksionet dhe informacionet e nevojshme për t'i mundësuar personelit të tyre të operationeve të aplikojnë dispozitat e kësaj rregulloreje;

b) sigurojnë që këto manuale janë konsistente, të qasshme dhe të përditësuara, si dhe përditësimi dhe shpërndarja e tyre i nënshtrohen menaxhimit të duhur të konfigurimit të cilësisë dhe dokumentimit;

c) sigurojnë se metodat e punës dhe procedurat operative janë në përputhje me këtë rregullore.

Neni 15 Sanksionet

Republika e Kosovës duhet të vendosë rregulla lidhur me sanksionet e zatushme për shkejet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato të zbatohen. Masat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse. Republika e Kosovës duhet ta njoftojë Komisionin për këto dispozita më së voni deri më 26 shtator 2011, si dhe do ta njoftojë pa vonesë për të gjitha ndryshimet e mëpastajme të tyre.

Neni 16 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më Xxxxxxxx

Realizuar në Prishtinë, xxxxxxxxxxxx.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm